

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **210-26-6187-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Angazhimin e një OE për Përditesimi i regjistrit(kadastrit), te mbeturinave te rrezikshme dhe kemikateve si dhe trajnimi i operatoreeve për plotësimin e të dhënave**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	digibrain SH.P.K.
NUI	811416470
Adresa	Bajram Bahtiri nr. 51
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Digi Brain
Adresa elektronike	hello@digibrain.cc
Data e parashtrimit të ankesës	21.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës.

Ankesa i përket grupeve:

Angazhimin e një OE për Përditesimi i regjistrarit(kadastrit), të mbeturinave të rrezikshme dhe kemikateve si dhe trajnimi i operatoreve për plotësimin e të dhënave Pas pranimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues me të cilin është refuzuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim, parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së duke mbetur plotësisht pranë të njëjtave pretendime, fakte dhe bazë juridike të paraqitura në procedurën paraprake pranë Autoritetit Kontraktues, pa shtuar apo ndryshuar natyrën e pretendimeve ankimore.

Pretendimi ynë kryesor mbetet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit për posedimin e certifikimeve profesionale në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikimeve ekuivalente që dëshmojnë kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave, kërkesë kjo e konfirmuar edhe përmes sqarimeve zyrtare të Autoritetit Kontraktues.

Në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur qëndrimin se dokumentacioni i OE-së së rekomanduar e përmbush kriterin, duke iu referuar mundësisë së pranimit të certifikimeve ekuivalente. Megjithatë, vendimi nuk identifikon konkretisht cilën certifikatë të dorëzuar e konsideron ekuivalente, me cilin certifikim të kërkuar e barazon atë dhe mbi çfarë baze teknike e profesionale është konstatuar ekuivalenca, përkatësisht se si certifikata konkrete dëshmon kompetencën e kërkuar në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave.

Për këtë arsye konsiderojmë se përgjigjja e Autoritetit Kontraktues nuk i ka rrëzuar argumentet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm që dëshmon se kriteri i kontestuar është përmbushur sipas përmbajtjes dhe qëllimit të Dosjes së Tenderit dhe sqarimeve të vetë AK-së.

Rrjedhimisht, përmes kësaj ankese kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë ligjshmërinë e vlerësimit të bërë nga Autoriteti Kontraktues, veçanërisht në raport me përgjegjshmërinë e tenderit sipas Nenit 59.4 të LPP-së dhe me zbatimin e njëjtë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht për të gjithë Operatorët Ekonomikë.

Kjo ankesë nuk paraqet pretendime të reja, por vazhdim të drejtpërdrejtë të kontestit të ngritur dhe trajtuar paraprakisht pranë Autoritetit Kontraktues.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, kemi ushtruar brenda afatit ligjor të drejtën tonë për paraqitjen e Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke kundërshtuar ligjshmërinë dhe mënyrën e vlerësimit të tenderit të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Në Kërkesën për Rishqyrtim kemi paraqitur në mënyrë të detajuar pretendimin se nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk dëshmohet përmbushja e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit lidhur me posedimin e certifikimeve profesionale në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikimeve ekuivalente që dëshmojnë kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave.

Ky pretendim është mbështetur jo vetëm në formulimin e qartë të Dosjes së Tenderit, por edhe në sqarimet zyrtare të dhëna nga vetë Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së tenderimit, përmes të cilave AK ka konfirmuar se certifikimet e cekura pranohen dhe se personi i propozuar duhet të jetë i certifikuar për fushat e kërkuara.

Përmes Kërkesës për Rishqyrtim kemi argumentuar se dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për stafin e propozuar përbëhen nga certifikime në fusha të tjera, si Scrum, Agile, marketing, menaxhim projektsh dhe fusha të tjera, si dhe nga certifikata për përfundim apo pjesëmarrje në kurse dhe trajnime. Sipas pretendimit tonë, nga asnjëra prej këtyre dëshmive nuk rezulton përmbushja e kërkesës konkrete të Dosjes së Tenderit për certifikim profesional në teknologjitë e kërkuara

apo për një certifikim ekuivalent që dëshmon kompetencën e përcaktuar nga AK.

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim, ka nxjerrë vendim me të cilin kërkesa është refuzuar si e pabazuar dhe është lënë në fuqi vendimi paraprak për rekomandimin e OE-së për dhënie të kontratës.

Në arsyetimin e këtij vendimi, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur qëndrimin se dokumentacioni i dorëzuar nga OE i rekomanduar përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit, duke iu referuar faktit se përveç certifikimeve të specifikuara janë lejuar edhe certifikime ekuivalente.

Megjithatë, në vendimin e AK-së nuk është identifikuar konkretisht se cila nga certifikatat e dorëzuara nga OE i rekomanduar është konsideruar ekuivalente me kërkesën e Dosjes së Tenderit, me cilin prej certifikimeve të kërkuara është barazuar ajo, cilat kompetenca konkrete profesionale i dëshmon dhe mbi çfarë analize teknike apo profesionale është konstatuar se përmbush kërkesën për kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave.

Për më tepër, përgjigjja e AK-së nuk adreson në mënyrë konkrete dallimin e ngritur në Kërkesën për Rishqyrtim ndërmjet certifikimit profesional në fushën e kërkuar dhe certifikatave që dëshmojnë vetëm përfundimin e trajnimeve, kurseve apo certifikimeve në fusha të tjera. Për këtë arsye konsiderojmë se vetëm referimi i përgjithshëm në nocionin “certifikim ekuivalent”, pa identifikim dhe arsyetim konkret të ekuivalencës, nuk i rrëzon faktet dhe argumentet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Rrjedhimisht, duke qenë se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim dhe ka lënë në fuqi vendimin e kontestuar, parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së duke mbetur në tërësi pranë pretendimeve, fakteve dhe bazës juridike të paraqitura në procedurën paraprake pranë Autoritetit Kontraktues.

Përmes kësaj ankese nuk paraqesim pretendime të reja dhe nuk ndryshojmë objektin e kontestit, por kërkojmë që OSHP të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe nëse vlerësimi i bërë ndaj tenderit të OE-së së rekomanduar është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, sqarimet zyrtare të AK-së dhe dispozitat përkatëse të LPP-së, në veçanti kërkesat që lidhen me përgjegjshmërinë e tenderit.

Kopja e Vendimit të Autoritetit Kontraktues të nxjerrë gjatë procedurës paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas nenit 108/A të LPP-së i bashkëngjitet kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e supozuara të shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

- Neni 59.4 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim / Jo-diskriminimi dhe neni 40.6 i Rregullores për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1 – Shkelja e Nenit 59.4 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues ka konsideruar si të përgjegjshëm tenderin e OE-së, edhe pse nga dokumentacioni i ofertës nuk dëshmohet përmbushja e një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, AK ka kërkuar që eksperti të posedojë certifikime profesionale në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services ose certifikime ekuivalente që dëshmojnë kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave.

Si dëshmi është kërkuar edhe kopja e certifikatës profesionale.

Gjatë fazës së sqarimeve, AK ka konfirmuar se “Cilado nga certifikimet e cekura pranohet” dhe se një person mund të mbulojë pozitat përkatëse vetëm “nëse është i certifikuar për fushat e kërkuara”.

Nga dokumentacioni i OE I rezulton se janë propozuar AB si Udhëheqës i Projektit, SHG si Zhvillues i Softuerit dhe GSalihi e GSylejmani si staf mbështetës.

Megjithatë, nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton asnjë certifikatë profesionale që përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përkatësisht certifikim në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikim ekuivalent që dëshmon kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave.

Deklarimi në CV i njohurive në .NET, ASP.NET, SQL Server apo teknologji të tjera nuk mund të barazohet me posedimin e certifikimit profesional, kur Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht certifikatë profesionale dhe kopjen e saj.

Sipas Nenit 59.4 të LPP-së, tenderi mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në rastin konkret, mungesa e dëshmisë për një kriter minimal teknik dhe profesional nuk përbën devijim të vogël, por prek një aspekt material të kualifikimit të tenderuesit.

Ne anen tjetër, nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar për SHG rezulton se janë paraqitur tri dëshmi kryesore: Project Management Practice Training – Raiffeisen Bank, Superior Customer Service Quality – Raiffeisen Bank dhe Scrum Master Training – ITCE.

Dokumenti Project Management Practice Training – Raiffeisen Bank dëshmon pjesëmarrje dhe përfundim të një trajnimit në fushën e menaxhimit të projekteve, përfshirë Project Set-up, Project Delivery dhe Project Closure. Ky dokument është Certificate of Participation dhe nuk përbën certifikim teknik në teknologjitë e kërkuara nga Dosja e Tenderit.

Dokumenti Superior Customer Service Quality – Raiffeisen Bank është po ashtu Certificate of Participation dhe dëshmon pjesëmarrje në trajnim në fushën e shërbimit ndaj klientit. Ky trajnim nuk ka lidhje me kërkesën për certifikim profesional në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikim ekuivalent. Ndërsa dokumenti Scrum Master Training – ITCE dëshmon se SHG ka “successfully completed Scrum Master Training”. Pra, dokumenti dëshmon përfundimin e një trajnimit në Scrum dhe nuk paraqet certifikim profesional në teknologjitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Rrjedhimisht, nga asnjëra prej dëshmive të dorëzuara për SHG nuk dëshmohet posedimi i certifikimit profesional në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo i ndonjë certifikimi ekuivalent që dëshmon kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe sqarimet zyrtare të Autoritetit Kontraktues.

Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar për AB rezulton se janë paraqitur disa lloje të ndryshme certifikatash dhe dëshmish, mirëpo asnjëra prej tyre nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit për certifikim profesional në Microsoft SQL

Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikim ekuivalent që dëshmon kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave.

Në grupin e certifikimeve të mirëfillta profesionale, janë paraqitur: Scrum Fundamentals Certified – SCRUMstudy, që dëshmon kalimin e një provimi certifikues në Scrum/Agile; Digital Marketing Fundamentals – SMstudy dhe Marketing Research Fundamentals – SMstudy, që janë certifikime në fushën e marketingut; si dhe EIPASS Trainer, që lidhet me metodologjinë dhe kompetencat për trajner EIPASS. Edhe pse këto dokumente paraqesin certifikime, asnjëra nuk lidhet me teknologjitë apo kompetencat teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Janë dorëzuar gjithashtu një numër certifikatash për përfundim ose pjesëmarrje në kurse dhe trajnime, përfshirë Foundations of Project Management – Google/Coursera, Agile Scrum Foundation – SkillUp/Simplilearn, Scrum Master Certification – LearnQuest/Coursera, Introduction to Agile Development and Scrum – IBM/Coursera, Build a Product Roadmap with Aha!, Getting Started with Azure DevOps Boards dhe Business Analysis & Process Management. Vetë dokumentet i përshkruajnë këto si “online non-credit course”, “online non-credit project”, “Declaration of Completion” apo përfundim specializimi/kursesh. Rrjedhimisht, ato dëshmojnë përfundimin e kurseve, trajnimeve apo projekteve online dhe jo posedimin e një

certifikimi profesional në teknologjitë e kërkuara nga AK.

Sa i përket Android App Development – ICK, dokumenti dëshmon përfundimin e një trajnimit 60-orësh në Java/Android Studio, UI, API, SQLite dhe fusha të ngjashme. Megjithatë ky trajnim ka lidhje me zhvillimin e aplikacioneve, dhe dëshmon përfundimin e një trajnimit, jo certifikim profesional në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo ndonjë certifikim ekuivalent të kërkuar nga Dosja e Tenderit.

Gjithashtu janë paraqitur Fundamentals of Digital Marketing – Google Digital Garage, që lidhet me marketingun digjital, Elementary Course – Qendra Kulturore Dardania, si dhe një Mirënjohje nga Kolegji Riinvest për ligjërime/ushtrime në Arkitekturë Kompjuteri, HTML, CSS dhe JavaScript. Këto dokumente nuk dëshmojnë certifikim profesional në fushat teknike të kërkuara.

Rrjedhimisht, nga asnjëra prej certifikatave dhe dëshmive të dorëzuara për AB nuk dëshmohet përmbushja e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit për posedimin e certifikimeve profesionale në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikimeve ekuivalente që dëshmojnë kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave. Dokumentet e dorëzuara përbëhen ose nga certifikime në fusha të tjera, ose nga certifikata të përfundimit/pjesëmarrjes në kurse dhe trajnime, dhe asnjëra nuk dëshmon se personi i propozuar është i certifikuar për fushat e kërkuara, siç është përcaktuar edhe në sqarimet zyrtare të Autoritetit Kontraktues.

Rrjedhimisht, nga asnjëra prej certifikatave dhe dëshmive të dorëzuara nga OE për stafin e propozuar nuk dëshmohet përmbushja e kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit për posedimin e certifikimeve profesionale në Microsoft SQL Server, .NET, ASP.NET, XML Web Services apo certifikimeve ekuivalente që dëshmojnë kompetencë në zhvillimin e aplikacioneve dhe bazave të të dhënave. Certifikatat e dorëzuara janë ose certifikime në fusha të tjera që nuk lidhen me kërkesën konkrete të DTsë, ose dëshmi për përfundimin/pjesëmarrjen në trajnime dhe kurse. Po ashtu, asnjëra nga dëshmitë e dorëzuara nuk rezulton se përmbush sqarimin zyrtar të AK-së, sipas të cilit personi i propozuar duhet të jetë “i certifikuar për fushat e kërkuara”. Për rrjedhojë, kriteri i përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe i konfirmuar përmes sqarimeve të AK-së nuk është dëshmuar si i përmbushur.

Pretendimi 2 Shkelja e Nenit 40.6 të Rregullores dhe Nenit 7 të LPP-së

Neni 40.6 i Rregullores për Prokurim Publik përcakton se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse OE përmbush kriteret e përzgjedhjes.

Pranimi i përvojës profesionale, njohurive të deklaruara në CV, certifikatave të trajnimit apo certifikimeve në fusha të tjera si zëvendësim për certifikimin profesional të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit do të përbënte në substancë ndryshim ose moszbatim të kriterit të përcaktuar paraprkishtë nga vetë Autoriteti Kontraktues gjatë

fazës së vlerësimit.

Një qasje e tillë cenon gjithashtu parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së, pasi të gjithë OE-të kanë qenë të obliguar t'i përgatisin ofertat në përputhje me të njëjtat kërkesa dhe sqarime të AK-së.

Përfundim

Bazuar në faktet dhe dëshmitë e paraqitura më sipër, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të detyrueshëm për certifikimin profesional të ekspertit, as sipas kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe as sipas sqarimeve zyrtare të dhëna nga Autoriteti Kontraktues.

Kjo mangësi lidhet drejtpërdrejt me një kriter minimal të kapacitetit teknik dhe profesional dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet devijim i vogël në kuptim të Nenit 59.4 të LPP-së. Tenderi i cili nuk dëshmon përmbushjen e këtij kriteri nuk mund të konsiderohet në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të aprovojë si të bazuar Kërkesën për Rishqyrtim;
- Të anulojë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së – B58 në pjesën që rekomandon OEpër dhënie të kontratës;
- Të kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim;
- Gjatë rivlerësimit të zbatojë në mënyrë të plotë dhe të barabartë kriteret e Dosjes së Tenderit dhe sqarimet zyrtare të AK-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e pretenduara nga Autoriteti Kontraktues krijojnë rrezik të drejtpërdrejtë dhe të matshëm për dëmtimin e interesit ekonomik të Operatorit Ekonomik parashtrues, pasi mbajtja në fuqi e vendimit aktual do ta privonte atë nga mundësia reale për t'u vlerësuar në një procedurë ku kriteret e Dosjes së Tenderit zbatohen në mënyrë të njëjtë dhe të plotë ndaj të gjithë pjesëmarrësve.

Në rast se procedura vazhdon mbi bazën e këtij vlerësimi, parashtruesi rrezikon humbjen e mundësisë për dhënien dhe realizimin e kontratës, përfshirë përfitimin ekonomik që lidhet me ekzekutimin e saj, si dhe humbjen e shpenzimeve dhe resurseve të angazhuara për përgatitjen e ofertës dhe pjesëmarrjen në këtë aktivitet të prokurimit.

Për këtë arsye, dëmi i pretenduar lidhet drejtpërdrejt me efektet ekonomike që mund të prodhojë një vendim i marrë mbi bazën e një vlerësimi që, sipas pretendimeve të paraqitura në këtë kërkesë, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.